

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6157  
E enjte, 5 nëntor 2020  
çmimi 0.40

## Gjeneral Rama kërkon mbështetjen e deputetëve për miratimin e kërkesave buxhetore të FSK-së



Na ndiqni edhe në:


[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

GJYKATA SPECIALE, PAS BASTISJES SË DJESHME TË SHTËPISË SË JAKUP KRASNIQIT NË PRISHTINË, E KA ARRESTUAR TË NJËJTIN DHE DËRGOUAR NË HAGË

# ARRESTOHET ZËDHËNËSI I LIRISË, DËRGOHET NË HAGË



## SULMI I VJENËS DHE NEVOJA PËR NJË QASJE SERIOZE NË RAPORT ME DIASPORËN SHQIPTARE

Shkruan: Valon MURATI



## INTERVENIMI FRIKËSUES DHE ARROGANT I GJYKATËS SPECIALE NDONËSE NUK KA KUNDËRSHTIM NGA ASKUSH!

F. 6  
KMDLNj

### AKTUALE

## MIRËMBAJTJA TEKNIKE E AUTOMJETEVE SHTON SIGURINË NË KOMUNIKACION

### EKONOMI



## ABRASHI NËNSHKRUAN MEMORANDUM PËR GJELBËRIMIN E RRUGËVE TË KOSOVËS

## IPKO MBETET PJESË E TELEKOMIT TË SLLOVENISË

### SPORT

## PRISHTINA U RIKTHEHET FITOREVE, DRITA S'GABON NDAJ '89-SHIT

# BIDEN DREJT FITORES

FAQE 2

Kandidati demokrat për zgjedhjet presidenciale në SHBA, Joe Biden është duke kryesuar në garën për president ndaj Donald Trumpit. Derisa numrimi i votave vazhdon, Joe Biden aktualisht ka 253 vota elektorale dhe Donald Trump 214. Një kandidat për president i duhen 270 vota elektorale për të hyrë në Shtëpinë e Bardhë. Në një deklaratë për mediat, Joe Biden, foli i sigurt se do të dalë fitimtar. "Nuk jam këtu për të deklaruar se kam fituar, por jam këtu për të thënë që kur të mbarojë numërimi, do të jemi fitues", ka thënë Biden.



## EDHE NËNTË TË VDEKUR DHE 546 RASTE TË REJA ME COVID NË KOSOVË

FAQE 7



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhep isht Tetov\*  
Gur'z-Perizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 000  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Mob: +377 44 501 289

ND, RTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878


**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOV.  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtin", Kosov\*,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

Pas mbylljes së vendvotimeve, qytetarët në mbarë Shtetet e Bashkuara po presin rezultatin e zgjedhjeve. Në garë të ngushtë janë presidenti aktual Donald Trump dhe kandidati demokrat Joe Biden

# Biden drejt fitores

Vendvotimet janë mbyllur në Shtetet e Bashkuara në mbrëmjen e 3 nëntorit, mirëpo shumë vota përmes postës janë ende duke u numëruar. Në orët e para të 4 nëntorit. Rezultati i zgjedhjeve presidenciale në Shtetet e Bashkuara mbetet i paqartë, kurse numërimi i votave në gjashtë shtete kyçe vazhdon ende. Kandidati demokrat Joe Biden ka thënë se është në rrugë drejt fitores, ndërkohë që presidenti amerikan, Donald Trump, ka shpallur fitoren para kohe dhe ka përsëritur pretendimet e pabazuara se votimi përmes postës është manipuluar



## Parashikuesit e zgjedhjeve e nxjerrin Bidenin favorit për të fituar

Gara për Shtëpinë e Bardhë midis presidentit aktual Donald Trump dhe kandidatit demokrat Joe Biden është ende e ngushtë, por parashikuesit e zgjedhjeve e nxjerrin Bidenin favorit për të fituar. Kompania e basteve Smarkets, me seli në Britaninë e Madhe, i jep Bidenit 78 për qind shanse për të dalë në krye, ndërsa PredictIt në Zelandën e Re parashikon shanse edhe më të mëdha për të: gati 80 për qind. Rritja e shanseve të

Bidenit vjen në kurriz të shanseve të Trumpit. Smarkets i jep presidentit aktual vetëm 21 për qind shanse për të qëndruar në Shtëpinë e Bardhë. Trump, para kohe, e ka shpallur veten fitues, por numërimi i votave që mund ta përcaktojnë rezultatin, vazhdon edhe në gjashtë shtete: Nevada, Xhorxhia, Miçigen, Karolinë e Veriut, Pensilvani dhe Uiskonsin. Biden duhet t'i fitojë të paktën tri nga këto shtete për t'u

zgjedhur president, ndërsa Trump duhet t'i fitojë së paku katër. Edhe përpara zgjedhjeve, Biden ka qenë në epërsi në sondazhet e opinionet në nivel kombëtar, por avantazhi i tij ka qenë më i vogël në shtetet e lëkundura, ku dy kandidatët kanë mbështetje të ngjashme në mesin e votuesve. Biden ka thënë se është i bindur se është "në rrugën e duhur" për të fituar, por ka bërë thirrje për durim derisa numërimi i votave vazhdon.

Uashington, 4 nëntor (ER) - Kandidati demokrat për zgjedhjet presidenciale në SHBA, Joe Biden është duke kryesuar në garën për president ndaj Donald Trumpit. Derisa numërimi i votave vazhdon, Joe Biden aktualisht ka 253 vota elektorale dhe Donald Trump 214. Një kandidat për president i duhen 270 vota elektorale për të hyrë në Shtëpinë e Bardhë. Në një deklaratë për mediat, Joe Biden, foli i sigurt se do të dalë fitimtar. "Nuk jam këtu për të deklaruar se kam fituar, por jam këtu për të thënë që kur të mbarojë numërimi, do të jemi fitues", ka thënë Biden. Sipas hartës elektorale, Bideni ka aktualisht 253 vota elektorale, ndërsa Trumpi 214. Shumë vota përmes postës janë ende duke u numëruar në Shtetet e bashkuara. Shtetet kyçe që priten ta përcaktojnë garën janë ato të Pensilvanisë, Miçiganit dhe Uiskonsinit. Për shkak të pandemisë së koronavirusit, një

numër rekord votash u hodhën me postë dhe numërimi i tyre ka bërë që procesi të zgjatet në kohë. Kandidati demokrat, Joe Biden, ka thënë se është në rrugë drejt fitores, ndërkohë që presidenti amerikan, Donald Trump, ka shpallur fitoren para kohe dhe ka përsëritur pretendimet e pabazuara se votimi përmes postës është manipuluar. Pjesëmarrja në zgjedhjet në ShBA, "më e larta në 120 vjet" Mbi 160 milionë amerikanë kanë votuar në zgjedhjet presidenciale të 3 nëntorit në ShBA, duke prodhuar shkallën më të lartë të pjesëmarrjes në 120 vjet. Këto janë të dhënat paraprake të Projektit të Zgjedhjeve në ShBA, mision i të cilit është sigurimi i statistikave zgjedhore. Sipas këtij Projekti, pjesëmarrja në zgjedhjet e së martës ka qenë 66.9 për qind, më e larta qysh në vitin 1900. Më 1900 pjesëmarrja ka qenë 73.7 për qind dhe presidenti



republikan, William McKinley, e ka mundur sfiduesin e tij demokrat, William Jennings Bryan. "Zgjedhjet presidenciale 2020 kanë pasur pjesëmarrjen më të lartë në 120 vjet", ka shkruar në "Twitter" themeluesi i Projektit të Zgjedhjeve, profesori Michael McDonald. Zgjedhjet në ShBA mbahen çdo katër vjet në të martën e parë të nëntorit dhe të drejtë vote ka secili shtetas amerikan mbi 18 vjeç. Rezultati mund të dihet në natën e zgjedhjeve, por mund të marrë edhe ditë ose javë. Presidenti i ri betohet zyrtarisht më 20 janar në një ceremoni që njihet si inaugurim.

# Gjeneral Rama kërkon mbështetjen e deputetëve për miratimin e kërkesave buxhetore të FSK-së



Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjeneralletenant Rahman Rama, ka pritur të mërkurën në takim deputetët e Kuvendit Kosovës, anëtarët e komisioneve parlamentare, atij për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes si dhe të komisionit për Buxhet dhe Transfere. Gjeneral Rama ka kërkuar nga anëtarët e dy komisioneve mbështetjen e tyre në Kuvendin e Kosovës për miratimin e kërkesave buxhetore të FSK-së të planifikuara për vitin 2021

aktuale të FSK-së, sfidat aktuale si dhe objektivat zhvillimor për të ardhmen.

Në vazhdim, përmes prezantimeve, oficerët e SHP të FSK-së i njoftuan të pranishmit me aspektin e mbrojtjes dhe të sigurisë në vend, për procesin planifikues të vitit pasues, afatmesëm dhe atij afatgjatë për ngritjen e aftësive dhe të kapaciteteve të plota operacionale të FSK-së si dhe kuadrit buxhetor të nevojshëm për realizimin e planeve përkatëse.

Ndër të tjera, gjeneral Rama ka theksuar se, pavarësisht prej krizës së shkaktuar nga pandemia Covid-19 dhe fokusit për luftimin e saj, FSK-ja ka arritur me sukses ta realizojë pjesën më të madhe të aktiviteteve të planifikuara, në funksion të përmbushjes

së objektivave të Ministrisë së Mbrojtjes. “Meqë jemi në vitin e dytë të procesit të tranzicionit të FSK-së në misionin e forcës ushtarake, edhe objektivat tona janë me fokus për përmbushjen e aktiviteteve në përputhje me planin gjithëpërfshirës të tranzicionit, respektivisht në drejtim të arritjes së aftësive dhe kapaciteteve të plota operacionale deri në vitin 2028, kapacitete këto të nevojshme për përmbushjen e misionit kushtetues dhe ligjor”, ka thënë Rama.

Komandanti i FSK-së ka kërkuar nga anëtarët e dy komisioneve mbështetjen e tyre në Kuvendin e Republikës së Kosovës për miratimin e kërkesave buxhetore të FSK-së të planifikuara për vitin 2021. Pas ekspozesë së gjeneral Ramës, anëtarët e

komisioneve përkatëse, të kryesuar nga Fatmire Kollçaku-Mulhaxha dhe Hekuran Murati, duke vlerësuar lart të arriturat e deritashme të FSK-së, me diskutimet dhe pyetjet e tyre shprehën interesimin lidhur me statusin e projekteve kapitale të blerjes dhe atyre infrastrukturore të FSK-së, për gjendjen e pjesëtarëve në rrethanat e pandemisë Covid-19, për procesin e integritetit të pjesëtarëve nga radhët e komuniteteve joshumicë dhe sfidat në këtë proces. Ata u zotuan se, pavarësisht prej vështirësive buxhetore që ka shkaktuar dhe pritet të shkaktojë pandemia, nga autoriteti i tyre do t'i mbështesin kërkesat buxhetore të FSK-së për realizimin e projekteve të planifikuara.

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjeneralletenant Rahman Rama, me stafin e vet ka pritur të mërkurën në Shtabin e Përgjithshëm të FSK-së deputetët e Kuvendit të

Republikës së Kosovës, respektivisht anëtarët e komisioneve parlamentare, të atij për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes si dhe të Komisionit për Buxhet dhe Transfere. Në fillim gjeneral Rama ka shprehur falënderimin për vizitën si dhe ka njoftuar deputetët lidhur me zhvillimet e përgjithshme

## Ministrja Haradinaj-Stublla kërkon përkrahjen e Italisë për vizat

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

ROMË, 4 NËNTOR - Ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës e Kosovës, Meliza Haradinaj-Stublla, të mërkurën ka zhvilluar takimin e parë bilateral në kuadër të vizitës zyrtare dyditore në Itali.

Ministrja Haradinaj-Stublla u prit në takim nga homologu i saj, ministri i Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar, Luigi di Maio, me ftesën e të cilit kryediplomatja e Kosovës po qëndron për vizitë zyrtare në Romë. “Ministrin di Maio i shpreha mirënjohjen e thellë ndaj Italisë për mbështetjen e

Kosovës gjatë pandemisë, duke përcjellë lutjet tona për mirëqenien e popullit italian, i dëmtuar ashpër prej Covid-19”, ka thënë ministrja Haradinaj-Stublla, duke bërë me dije se në këtë takim është diskutuar edhe mbi zgjerimin dhe dinamizimin e bashkëpunimit politik, ekonomik dhe ushtarak.

Shefja e diplomacisë e Kosovës ka kërkuar nga homologu i vet që Italia ta vazhdojë përkrahjen e zëshme për agjendën e liberalizimit të vizave për Kosovën dhe ta shtojë bashkëpunimin me FSK-në. “U pajtuam me ministrin di Maio se Ballkani Perëndimor ka nevojë për stabilitet, siguri dhe paqe të



qëndrueshme e që mund të arrihet vetëm përmes zgjidhjes përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë, që nuk injoron përgjegjësinë për të kaluarën tragjike të

popullit tonë dhe që respekton realitetin politik dhe ligjor të Republikës së Kosovës”, ka bërë me dije ministrja Haradinaj-Stublla. Ministri Di Maio e siguroi

homologen Haradinaj-Stublla se Italia do të vazhdojë të qëndrojë përkrah Kosovës për rrugëtimin e saj euroatlantik dhe se beson në lidhjen e fortë mes popujve.



GJYKATA SPECIALE, PAS BASTISJES SË DJESHME TË SHTËPISË SË JAKUP KRASNIQIT NË PRISHTINË, E KA ARRESTUAR TË NJËJTIN DHE DËRGOUAR NË HAGË

# ARRESTOHET ZËDHËNËSI I LIRISË, DËRGOHET NË HAGË

Pas konfirmimit të aktakuzës nga Dhomat e Specializuara në Hagë, është arrestuar ish-zëdhënësi i UÇK-së, Jakup Krasniqi. Arrestimi është bërë pas një aksioni të bastisjes në shtëpinë e Krasniqit nga Zyra e

Prokurorit të Specializuar, e mbështetur nga EULEX-i. Avokati i Krasniqit, Valon Hasani, ka deklaruar se pas arrestimit klienti i tij pritet të dërgohet në Hagë. Ai ka thënë se Krasniqi dyshohet për vepra të cilat

nuk janë të specifikuara, por janë në kuadër të veprave që bien nën juridiksionin e Speciales. Aksioni i bastisjes është kritikuar nga OVL-UÇK, Nisma Socialdemokrate dhe shumë ish-bashkëluftëtarë të Krasniqit

**EPOKA  
ERE**

**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Zyra e Prokurorit të Specializuar të mërkurën ka arrestuar ish-zëdhënësin e UÇK-së, Jakup Krasniqi. Arrestimi është bërë pas dhjetë orësh qëndrim të pjesëtarëve të Prokurorisë së Specializuar të Hagës në shtëpinë e tij në Prishtinë.

Avokati i Krasniqit, Valon Hasani, ka bërë me dije se pas arrestimit ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës është nisur për Hagë. "Prokuroria e Specializuar ka pasur një aksion dhe në bazë të urdhrat të cilin është lëshuar nga Dhomat e Specializuar, është bërë arrestimi i Jakup Krasniqit dhe tani sapo është nisur në Hagë. Është konfirmuar aktakuza kundër tij dhe pritet shumë shpejt të caktohet seanca", ka deklaruar

Hasani.

Ai nuk ka mundur të flasë më hollësisht rreth veprave për të cilat akuzohet Krasniqi. "Procedura ka zgjatur për shkak se ka qenë operacion i bastisjes në shtëpinë e z. Krasniqi. Sapo përfundoi bastisja z. Krasniqi është nisur drejt Hagës. Po dyshohet për veprat të cilat nuk janë të specifikuara, por janë vepra që bien në kuadrin e veprave në juridiksionin e Dhomave të Specializuara", ka deklaruar avokati.

Aksioni i bastisjes ka filluar para orës 6.00 të mëngjesit dhe ka zgjatur deri pas orës 15.00 të pasdites. Aksionin e bastisjes e kanë konfirmuar edhe Dhomat e Specializuara të Kosovës me seli në Hagë. Sipas njoftimit për media, operacioni është kryer me mbështetjen e Policisë së Kosovës dhe Misionit të



Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë. Familjaret e Krasniqit kanë bërë me dije se gjatë kohës së zhvillimit të aksionit të bastisjes, Krasniqi ishte izoluar në një dhomë në shtëpi. Sevdije Krasniqi, bashkëshortja e

Jakup Krasniqit, ka thënë për media gjatë ditës, se familja nuk ka pasur informacione se përse është duke u kryer operacion në shtëpinë e tyre. "Nuk na kanë ofruar kurrfarë dokumenti. Kështu që, nuk e dimë se cili është qëllimi ose arsyeja e

ardhjes në shtëpinë tonë", ka deklaruar ajo.

Kjo bastisje ka nxitur reagime të shumta në Kosovë. Organizatat e Veteranëve të Luftës së UÇK-së kanë theksuar se çdo veprim i Gjykatës Speciale jashtë mandatit të saj është i kundërligjshëm dhe kundërkushtetues. "Organizatat e dala nga lufta e UÇK-së reagojnë ndaj spektakleve që bëhen me anë të bastisjeve të pjesëtarëve të UÇK-së dhe konsiderojnë se çdo veprim i Gjykatës Speciale, jashtë mandatit të saj, është i kundërligjshëm dhe kundërkushtetues". Kjo organizatë ka vlerësuar se janë duke punuar me deputetët e Kuvendit të Kosovës që skadimi i mandatit i kësaj gjykate të dërgohet për interpretim në Gjykatën Kushtetuese.



**Nisma: Jakup Krasniqi  
çdoherë i është përgjigjur  
drejtësisë**

Edhe Nisma Socialdemokrate e ka kundërshtuar aksionin e Gjykatës Speciale. Sekretari i përgjithshëm i Nismës, Bilall Sherifi, në një konferencë për medie, ka thënë se Jakup Krasniqi çdoherë i është përgjigjur drejtësisë. “Ne të gjithë e njohim figurën emblematike të z.

Krasniqi. Vlerësojmë se kjo që kemi parë sot ka qenë e panevojshme. Njeriu i cili gjithë jetën ia ka kushtuar drejtësisë, i cili tërë jetën e tij ka luftuar për drejtësinë kolektive, ka sakrifikuar lirinë individuale në këtë luftë për drejtësi kolektive”, ka thënë ai. Ai ka deklaruar se të gjithë e dinë që Krasniqi çdoherë iu ka përgjigjur ftesave që kanë ardhur nga organet e drejtësisë, nga ato vendore dhe ndërkombëtare. Prandaj, sipas tij, skenat që janë parë të panevojshme për drejtësinë.

“Nisma Socialdemokrate ka besuar dhe beson fuqishëm në luftën për liri, drejtësi dhe pavarësi të Jakup Krasniqit. Jemi të bindur se askush dhe asgjë nuk mund ta njollosë jetën dhe veprën e tij në shërbim të atdheut. Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte arritja më e madhe e kombit shqiptar në shekullin që lamë pas dhe askush e asgjë nuk mund ta njollosë luftën e saj çlirimtare”, ka theksuar ai.

Ai ka thënë se Kosova ka zhvilluar një luftë të drejtë dhe ajo ka qenë viktimit e gjenocidit. “Qeveria e Kosovës, institucionet e Kosovës, Kuvendi, Presidenca duhet të jenë në krye të përgjegjësisë të veta në funksion të mbrojtjes së luftës së drejtë të UÇK-së. Tanimë beteja do të zhvendoset në sallat e gjyqit dhe institucionet e vendit duhet të përgatiten që të gjithë ata, përfshirë edhe z. Krasniqi, që i ka rënë hise të ballafaqohet me këtë padrejtësi, ta kenë mbështetjen e shtetit në mënyrë që edhe këtë betejë në sallat e gjyqit ta bëjmë bashkë si institucione dhe si shoqëri”, ka shtuar ai, duke shtuar se Nisma beson fuqishëm në pastërtinë e luftës së UÇK-së dhe të Krasniqit. “Krasniqi është njëri nga ne, është kryetar i Këshillit Kombëtar, ish-zëdhënës i UÇK-së dhe ish-kryetar i Kuvendit. Pra, bëhet fjalë për një person që personifikon

## Tomë Gashi: Bastisjet ende vazhdojnë dhe do të ketë edhe të tjera

Avokati Tomë Gashi ka reaguar pas aksionit të Gjykatës Speciale në Prishtinë, saktësisht për bastisjen e shtëpisë së Jakup Krasniqit. Ai në një shkrim publikuar në llogarinë e vet në “Facebook”, ka thënë se Gjykata Speciale ka akuzuar dhe do ta akuzojë hierarkinë më të lartë të UÇK-së sepse, sipas tij, kështu kanë votuar ata deputetë për krijimin e Speciales, raporton “Epoka e re”. “Gjykata Speciale ka akuzuar dhe do ta akuzojë hierarkinë më të lartë të UÇK-

së, sepse ju kështu keni votuar. Gjykata Speciale do t’i konfirmojë aktakuzat, sepse ju kështu keni votuar. Gjykata Speciale do t’i gjykojë pjesëtarët e UÇK-së, por jo ushtarët serbë, jo policët serbë, jo paramilitarët serbë, jo hierarkinë më të lartë të ushtrisë dhe policisë, sepse ju kështu keni votuar. Ky është vetëm fillimi dhe asgjë ende nuk kemi parë, se çfarë do të na bëjë Gjykata Speciale, sepse ju kështu keni votuar”, ka shkruar avokati Gashi.

Ai ka deklaruar se deri tani kemi

tre pjesëtarë të UÇK-së në burg në Hagë, duke shtuar se shumë shpejt do të kemi edhe shumë të tjerë. “Gjykata Speciale dalëngadalë po na shndërron në shqiptarëve nga viktima të luftës në agresorë, sepse ju kështu keni votuar. Bastisjet ende vazhdojnë dhe do të ketë edhe të tjera, sepse ju kështu keni votuar. Skena të tilla si të sotme, por edhe më të rënda do të shohim së paku edhe 10 në vjetër e ardhshëm, sepse ju kështu keni votuar”, ka deklaruar ai.

tërë historinë e Kosovës”, ka përfunduar ai.

### Qeveria: Do të bashkëpunojmë me drejtësinë

Qeveria e Kosovës ka reaguar pas bastisjes që po bëhet në shtëpinë e ish-kryeparlamentarit Jakup Krasniqi nga Gjykata Speciale. Qeveria ka njoftuar se po i

përcjell veprimet e EULEX-it lidhur me Krasniqin. “Kosova, bartësit e institucioneve si dhe qytetarët e saj në vazhdimësi kanë dhënë shembull të respektimit dhe bashkëpunimit me drejtësinë vendore dhe ndërkombëtare. Njëjtë do të veprohet edhe kësaj radhe me Dhomat e Specializuara në Hagë, të cilat janë pjesë e sistemit të drejtësisë të Republikës së Kosovës”, është thënë në

njoftimin e qeverisë.

Më tutje, qeveria ka theksuar se prezumimi i pafajësisë duhet të respektohet në çdo rast përderisa nuk ka një vendim tjetër të gjykatës kompetente. “Qeveria e Republikës së Kosovës e njeh si të patjetërsueshëm qëllimin e pastër e të shenjtë të popullit të Kosovës në luftën për liri”, është thënë në këtë njoftim.

Ndaj aksionit të Speciales kanë reaguar edhe shumë bashkëpartiakë të Krasniqit, zyrtarë të lartë të PDK-së dhe partive të tjera. “Defilimet e tilla nga EULEX-i, veçanërisht në prani të familjarëve, janë traumatike dhe paraqesin ushtrim të forcës joproporcionale që nuk respektojnë dinjitetin njerëzor. Operacionet e tilla, nëse kërkohen nga organet e drejtësisë, mund të kryhen nga Policia e Kosovës. Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka qenë e pastër dhe besojmë në pafajësinë e z. Jakup Krasniqi”, ka shkruar lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, në llogarinë e vet në “Facebook”.



## Mirëmbajtja teknike e automjeteve shton sigurinë në komunikacion

Prishtinë, 4 nëntor (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, bashkë me inspektoratin e kësaj ministrie dhe me Policinë e Kosovës, të mërkurën kanë përcjellë nga afër inspektimin e automjeteve të rënda të transportit rrugor. Abrashi ka thënë se aksione të tilla bëhen vazhdimisht dhe kanë për qëllim ngritjen e sigurisë në komunikacion. “Jemi sot këtu për të përcjellë nga afër aksionin e përbashkët, i cili po realizohet në mes të Policisë së Kosovës dhe inspektorëve të MI-së, e që ka të bëjë me inspektimin e automjeteve të rënda të transportit rrugor. Aksione të tilla realizohen në vazhdimësi. Këtë herë jemi në dy pika, në rrugën nacionale Prishtinë - Ferizaj dhe në Prishtinë - Mitrovicë. Ne si Ministri e Infrastrukturës, së



bashku me Policinë e Kosovës, kemi ngritur edhe një grup të përbashkët punues për t’i identifikuar vendet që paraqesin rrezikshmëri të lartë në komunikacionin rrugor. Edhe qëllimi

i këtij aksioni i cili po zhvillohet që nga fillimi i javës është në kuadër të ngritjes së sigurisë në komunikacion”, ka thënë ministri Abrashi.

Ai ka theksuar se edhe gjendja

teknike e automjeteve ndikon në ngritjen e sigurisë, duke apeluar te qytetarët që të kenë kujdes në komunikacion.

Ministri Abrashi ka treguar se për vitin e ardhshëm është planifikuar me buxhet edhe blerja e një kontrolle teknike mobile. “Ne po ndërtojmë rrugë, por edhe gjendja teknike e automjeteve është faktor për rritjen e sigurisë. Pra, edhe faktori njeri është element që ndikon në sigurinë rrugore. Meqenëse shumë shpjet hyjmë në sezonin e dimrit, u bëj thirrje të gjithë ngasësve në komunikacion t’i respektojnë rregullat e trafikut, t’i mirëmbajnë teknikisht automjetet e tyre dhe të kenë kujdes të shtuar në komunikacion. Kemi planifikuar edhe një kontroll teknike mobile, që të ndikojë në rritjen

e sigurisë në komunikacion. Bashkëpunimin institucional që pashë sot, na jep kurajë që të vazhdojmë fuqishëm të investojmë në sigurinë rrugore që të kemi rrugë më të sigurta dhe më pak aksidente”, ka deklaruar Abrashi.

Ndërsa drejtori i Divizionit të Komunikacionit Rrugor në Policinë e Kosovës, Jeton Rexhepi, ka thënë se ky aktivitet i përbashkët është i fokusuar te faktori automjet, duke i kontrolluar automjetet në aspektin teknik, për ta rritur sigurinë në komunikacion.

Drejtori i Inspektoratit, Çerkin Dukolli, ka thënë se të gjitha angazhimet po bëhen për ngritjen e sigurisë në komunikacion në mënyrë që të kemi rrugë më të sigurta dhe sa më pak aksidente.

Reagim i KMDLNj-së

# Intervenimi frikësues dhe arrogant i Gjykatës Speciale ndonëse nuk ka kundërshtim nga askush!

Sipas informatave të KMDLNj-së, forca të mëdha policore të EULEX-it dhe Gjykatës Speciale, më 4 nëntor 2020, para orës 6:00 të mëngjesit rrethuan shtëpinë ku jeton Jakup Krasniqi, ish i burgosur politik, zëdhënës i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në kohë lufte, bartës i posteve ministore pas përfundimit të luftës dhe ish-kryetar i Kuvendit të Kosovës dhe një kohë edhe ushtrues detyre i presidentit të Kosovës. Po këto forca policore bllokuan të gjitha rrugët në pjesën ku e ka shtëpinë Jakup Krasniqi. Që nga ora 6:00 e mëngjesit, Jakup Krasniqi, i izoluar nga familja është intervistuar nga hetues të Gjykatës Speciale. Po në të njëjtën kohë forca të mëdha policore rrethuan shtëpinë e Jakup Krasniqit në Negroc (nga ora 5:00 e mëngjesit) në pritje të një urdhri për bastisje nga Gjykata Speciale. Jakup Krasniqi në muajin korrik të vitit 2019 ishte ftuar për intervistim, si i dyshuar nga Gjykata Speciale në Hagë dhe me kohë ishte përgjigjur ftesës për intervistim duke e informuar opinionin për ftesën nga kjo gjykatë. Edhe pas intervistimit nga kjo gjykatë, Jakup Krasniqi nuk kishte marrë asnjë veprim në kundërshtim të kësaj gjykate apo pengim të punës së saj duke shfaqur gatishmëri që në çdo kohë t'i përgjigjet ftesës së kësaj gjykate. Në prononcimet publike Jakup Krasniqi në asnjë rast nuk e bëri publik intervistimin e tij në Hagë por se në çdo deklaram publik e

ka mbrojtur luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Kohë më parë kjo gjykatë e arrestoi Salih Mustafën-Calin dhe me urgjencë e transferoi në Qendrën e Paraburgimit në Hagë. As gjatë këtij arrestimi nuk pati kundërshtime dhe, pa asnjë arsye është terrorizuar familja e Salih Mustafës. Në mënyrën më të vrazhdë të, përmes demonstrimit të një arrogance për frikësim, policë të Gjykatës Speciale, me logo të "hakmarrësve" në uniformat e tyre të marrë nga një film i dhunshëm arrestuan krerët e OVL-së të UÇK-së, ndonëse as këta nuk e kundërshtuan arrestimin, për t'i dërguar pastaj (pa viza) dhe me procedurë të përsheptuar në Qendrën e Paraburgimit të Gjykatës Speciale në Hagë. Deri më tani, vetëm një apo dy rasteve në më shumë se 350-400 rasteve të ftuar për intervistim, kanë refuzuar të lajmërohen me kohë dhe në vendin e caktuar për intervistim e që nuk ka ndodhur me asnjë vend tjetër nga hapësira e ish-Jugosllavisë që janë trajtuar nga Tribunali për Krime Luftë për ish-Jugosllavinë në Hagë apo gjykatat e specializuara vendore. Nëse të gjithë të ftuarit për intervistim në cilësi të të dyshuarit apo dëshmitarit janë lajmëruar me kohë për intervistim apo kur për shkaqe objektive shëndetësore (Covid-19) nuk kanë mundur të lajmërohen, e kanë informuar këtë gjykatë me kohë për arsyen. Nëse të gjithë të ftuarit janë

deklaruar se do të bashkëpunojnë me drejtësinë ndërkombëtare (drejtësi selektive e mbështetur në interesa politike dhe parime etnike) atëherë, KMDLNj nuk e sheh aspak të arsyeshme veprimet arrogante dhe frikësuese të Gjykatës Speciale që e përdorë si instrument dhune policinë e pidentifikuar dhe shkel të drejtat e njeriut të familjarëve por edhe të arrestuarve përmes demonstrimit të një force krejtësisht të panevojshme! Të mbahen për disa orë në kushte tmerrri familjarët, është shkelje flagrante e të drejtave të njeriut dhe në kundërshtim të plotë me veprimet e ish Tribunalit për Krime Luftë për ish-Jugosllavinë që të akuzuarit i ftonë të paraqiten para Tribunalit dhe pastaj i arrestonte. Kemi qenë dëshmitarë se shumë të akuzuar për krime monstruoze në Kroaci, Bosnje dhe Kosovë, kur shkonin në Tribunal të Hagës shkonin me përcjellje shtetërore dhe pompozitet sikur të shkonin të merrnin Çmimin Nobel për Paqe!


Kosova nuk po e dëshmon se është shtet që i mbron qytetarët e saj nga arbitrariteti i burokratëve ndërkombëtarë që po e shpërfillin shtetin e Kosovës, deri në përbuzje. Nëse një burokrat që haptazi është rreshtuar kundër pavarësisë së Kosovës dhe në anë e Serbisë, si puna e Borrellit që është mbajtës i postit me rëndësi në BE e që qartazi bënë politikë anuese kërkon nga

presidenti i Kosovës që ka mandat të plotë dhe i cili i përgjigjet vetëm Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, të konsultohet me këtë burokrat antikosoovar për veprimet që janë përgjegjësi ekskluzive kushtetuese e presidentit të Kosovës e aspak të proserbit dhe burokratit Borrell qartazi e tregon pafuqinë vendimmarrëse të institucioneve kosovare. Pastaj, nëse një antikosoovar i certifikuar dhe urrejtës i pavarësisë së Kosovës, mik i madh i Serbisë, burokrati Lajçak, pa fije turpi dhe duke u kërcënuar kërkon ndryshimin e Kushtetutës së Kosovës duke e llogaritur si letër tualeti për ta zyrtarizuar Republika Serpsken në Kosovë, Asociacionin e Serbisë në Kosovë dhe se prapë bisedohet me te, nuk është asgjë tjetër përveç shpërfaqje e një pafuqie dhe dorëzimi ndaj Serbisë të personalizuar në burokratin Lajçak.

Nëse vazhdohet me këtë ndërhyrje mujshare në punët e një shteti të pavarur dhe sovran nga burokratë politikisht të korruptuar dhe kriminalizuar, pse atëherë të mos bëhet Borrelli kryetar i Kosovës, Lajçaku, kryeministër i Kosovës apo Ana Bernabiq kryetare e Kuvendit të Kosovës?! Ç'kuptim kanë institucionet e Kosovës kur nuk llogariten as si vasalë nga burokratët e kriminalizuar ndërkombëtarë! Nëse policë të pidentifikuar, të kontrabanduar si policë të Gjykatës Speciale, pa asnjë paralajmërim

demonstrojnë frikë dhe terrorizojnë familjet e të dyshuarve por edhe qytetarët që nuk pajtohen me ta, kur të duan arrestojnë kë të duan dhunshëm atëherë pse, p. sh., një polic i Rumanisë që mund të ketë qenë ekzekutues i protestuesve paqësorë, Mon Balaj dhe Arben Xheladini, të mos bëhet Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës?!

Duke falënderuar qëndrimin bashkëpunues të të ftuarve për intervistim nga Gjykata Speciale, qoftë si të dyshuar apo dëshmitarë, situata e sigurisë në Kosovë ka qenë e qëndrueshme deri më tani, pa asnjë përshkallëzim të dhunshëm. Gjykata Speciale po e keqpërdorë skajshmërisht këtë bashkëpunim dhe me arrestimet që i ka bërë, seriozisht po kontribuon në përkeqësimin e situatës së sigurisë. Nëse nuk ka fare kundërshtim, pse atëherë të demonstron forca dhe dhuna, mjafton të dërgohet një ftesë për paraqitje para kësaj Gjykate. KMDLNj është e sigurt se, edhe në rast që të akuzuarit marrin konfirmim të aktakuzës dhe se duhet të shkojnë në burg, këtë do ta bënin pa kundërshtuar sikur që e kanë bërë në të gjitha rastet deri më tani, nga koha e ish-Tribunalit për Krime Luftë për ish-Jugosllavi e deri te kjo Gjykatë Speciale që pretendon se ndanë drejtësi e që e bënë sipas parimit etnik ndërsa ndanë padrejtësi duke mos siguruar drejtësi për, së paku 95 për qind të viktimave, gjithashtu sipas parimit etnik!



# Edhe nëntë të vdekur dhe 546 raste të reja me Covid në Kosovë

Nëntë viktimë dhe 546 raste të reja me Covid-19 u konfirmuan të mërkurën në Kosovë. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike ka njoftuar se rastet e reja pozitive rezultojnë nga testimi i 1 626 mostrave. Numri më i madh i tyre është në Prishtinë: 286. Po ashtu, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike ka njoftuar se në 24-orëshin paraprak, 107 pacientë janë shëruar nga ky virus

**EPOKA  
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 1 626 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 546 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar nëntë raste të personave të vdekur nga Covid. Numri total i rasteve pozitive është 21 545 raste nga 100 395 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 714 raste të të vdekurve

po nga ky infeksion. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 107 pacientë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 15 829 raste, kurse numri i rasteve aktive është 5 002.

Rastet pozitive janë nga: Komuna Prishtinë 286 raste, Komuna Gjakovë 37 raste, Komuna Fushë-Kosovë 31 raste, Komuna Prizren 28 raste, Komuna Ferizaj 27 raste, Komuna Gjilan 17 raste, Komuna Lipjan 15 raste, Komuna Obiliq 12 raste, Komuna Rahovec 12 raste, Komuna Vushtrri 12 raste, Komuna Pejë 11 raste, Komuna Deçan 10 raste, Komuna Drenas 9 raste, Komuna Malishevë 8 raste, Komuna Suharekë 6 raste, Komuna Mitrovicë 4 raste, Komuna Shtime 4 raste, Komuna

Istog 3 raste, Komuna Klinë 3 raste, Komuna Podujevë 3 raste, Komuna Skenderaj 3 raste, Komuna Kaçanik 2 raste dhe me nga një rast Komunat Dragash, Kamenicë dhe Kllokot. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës u ka bërë thirrje qytetarëve, institucioneve publike dhe private, bizneseve, gastronomëve, që në mënyrë strikte ta respektojnë distancën fizike, përdorimin e maskave, dezinfektimin dhe ajrosjen e

lokaleve, duke pamundësuar përhapjen eventuale të infeksionit dhe shmangien e përhapjes në hapësirat e mbyllura. "Si pasojë e mosbartjes së maskave nga ju, qytetarë të nderuar, po rrezikohet shëndeti juaj dhe i qytetarëve të tjerë dhe po rëndohet situata e përgjithshme epidemiologjike që po mbahet nën kontroll me mund të madh të ekipeve të profesionistëve të Institutit Kombëtar", është theksuar në mesazhin e IKShPK-së.

## Ushtarët italianë dhurojnë pajisje mbrojtëse në Klinikën për Sëmundjet Infektive

Ekipi mjekësor ushtarak italian i cili po vepron në Kosovë në mbështetje të institucioneve shëndetësore promovoi dhurimin e maskave të fytyrës dhe kostumeve mbrojtëse për Klinikën e Sëmundjeve Infektive në Kosovë. Pajisjet u dorëzuan të mërkurën nga ushtarët italianë të Komandës Rajonale të KFOR-it Perëndim. "Ekipi italian përbëhet nga mjekë dhe infermierë nga të gjitha Forcat e Armatosura Italiane dhe po ndihmon strukturat shëndetësore në Kosovë në përgjigjen e tyre ndaj Covid-19, përmes një numri aktivitetsesh, përfshirë këshillimin mjekësor dhe sondazhet e kryera në të gjithë Kosovën", ka shpjeguar Majori Cristian Benegiamo, udhëheqës i ekipit. Dr. Lindita Ajazaj-Berisha ka falënderuar ekipin mjekësor ushtarak italian për mbështetjen e tyre dhe për ndarjen e përvojës së tyre të specializuar për menaxhimin e Covid-19 me kolegët e tyre në Kosovë. KFOR-i po lehtëson aktivitetet e ekipit brenda kornizës së ndihmës së siguruar bashkërisht për institucionet në Kosovë nga ministrinë italiane të Mbrojtjes dhe Punëve të Jashtme.



## Shefi i zyrës së BE-së mbështet KOZ-në

PRISHTINË, 4 NËNTOR (ER) - Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Valdete Daka, ka pritur të mërkurën në takim njoftues shefin e Zyrës së BE-së, njëherësh përfaqësues i posaçëm i BE-së, Tomas

Szunyog. Kryetarja e KOZ-së i uroi detyrën e re Szunyogit, duke shprehur gatishmërinë për thellim të bashkëpunimit me qëllim të avancimit të proceseve zgjedhore në vendin

tonë. Po ashtu, Daka e njoftoi edhe lidhur me përgatitjet që janë duke u kryer për organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar në Komunën e Podujevës dhe të Mitrovicës së

Veriut, të cilat do të mbahen më 29 nëntor 2020. Ndërkaq ambasadori i BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, ka shprehur mbështetje për punën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.



# Të premten protestojnë punëtorët e Telekomit



**PRISHTINË, 4 NËNTOR (ER)** - Federata Sindikale e Pavarur e Postës dhe Telekomit të Kosovës (FSP-PTK) ka njoftuar të premtën, më 6 nëntor, duke filluar nga ora 11:00-12:00, do të mbahet protestë në shenje pakënaqësie për zhvillimet e fundit në Telekom pas bllokimit të xhirollogarisë. Sipas FSP-PTK, nëse nuk merren parasysh kërkesat e FSP-PTK të cilat janë

bërë më 29 tetor, atëherë do të ketë protesta dhe greva. "Javët e fundit ka qenë të rënda për Telekomin e Kosovës dhe për neve si punonjës. Fillimisht, janë bllokuar xhirollogaritë dhe më 29.10.2020 janë tërhequr të gjitha mjetet financiare nga ish-kompania 'Dardafon' dhe zhvatësi, oligarku 10-vjeçar Blerim Devolli dhe përmbaruesi Ilir Mullhaxha. FSP-PTK, edhe

pse është në kontakt të vazhdueshëm me institucionet shtetërore, ku kemi bërë përpjekje për gjetjen e një zgjidhje të shpejtë përmes dialogut social me të gjitha palët e përfshira, deri më tani nuk kemi hapa konkretë nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit!", është thënë në njoftimin e FSP-PTK.

Sipas këtij njoftimi, FSP-PTK, sipas ligjeve në fuqi dhe statutit të Sindikatës, ka paralajmëruar në konferencën e datës 2.11.2020 për hapat që do të ndërmerren në ditët në vazhdim. "Protesta do të fillojë nga data 6.11.2020 sipas hapave të paralajmëruar (e premtë, protestë 1h nga 11:00-12:00) para objekteve kryesore të Telekomit në të gjitha qendrat e

Kosovës. Nëse nuk merren parasysh kërkesat e FSP-PTK të cilat janë bërë të qarta më 29.10.2020, atëherë protestat dhe grevat do të vazhdojnë sipas paralajmërimeve. FSP-PTK ka marrë përkrahje edhe nga Sindikata e Postës së Kosovës, FSP-Elektrokosova dhe sindikata e re e KEK-ut. Protesto edhe ti...!", është theksuar në njoftimin e FSP-PTK.

## Në Shalë të Bajgores do të mbahet panairi për promovimin e bukurive natyrore

**PRISHTINË, 4 NËNTOR (ER)** - Nënkrjetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, ka pritur të mërkurën në takim përfaqësuesit nga Oda e Hotelierisë dhe Turizmit të Kosovës, dega në Mitrovicë, Lulzim Sylejmani, Fatmir Riza, Abdullah Murati dhe Sabedin Salihu.

Qëllimi i këtij takimi ishte të njoftohej Komuna e Mitrovicës lidhur me organizimin e panairit "Shala e Bajgores" më 18 nëntor, në ambientet e

Shalës, nga Oda e Hotelierisë dhe Turizmit në Mitrovicë, me synim që ta promovojnë rajonin e Shalës si zonë turistike jo vetëm në Kosovë, por edhe për vizitorët e huaj që mund të vijnë këtu dhe t'i shijojnë bukuritë natyrore të këtij vendi.

Me këtë rast, nënkryetari Mujka ka përgëzuar të pranishmit për këtë iniciativë, duke thënë se rajoni i Shalës ofron mundësi të shumta, qoftë për turizëm, për blegtori, apo për zhvillim

ekonomik, ku me investime të shumta që janë kryer dhe po vazhdojnë të realizohen në ato vende, po shndërrohet në një zonë tejet atraktive për ta vizituar jo vetëm qytetarët mitrovicas, por edhe qytetarë nga vende të tjera. Në fund të takimit, përfaqësuesit në fjalë kanë kërkuar që gjatë mbajtjes së panairit të respektohen në përpikëri masat e reja të vendosura nga qeveria me qëllim të mbrojtjes nga virusi Covid-19.



## IPKO mbetet pjesë e Telekomit të Sllovenisë

**PRISHTINË, 4 NËNTOR** - Telekom i Sllovenisë përmes një njoftimi ka bërë me dije se ka përmbyllur procedurat, por nuk ka zgjedhur një blerës për operatorin e telefonisë mobile IPKO, që vepron në Kosovë. Përmes këtij njoftimi, Telekom Sllovenia tha se IPKO do të mbetet pjesë e grupit të

këtij telekomit. Operatori i telekomunikimeve IPKO është operatori i dytë më i madh në Kosovë, pas Telekomit të Kosovës. Në vitin 2005, Telekom i Sllovenisë kishte përzgjedhur Kosovën për të investuar në tregun e telekomunikimeve, duke blerë aksione në ofruesin e

shërbimeve të internetit në vend, IPKO. Telekom i Sllovenisë e kishte nxjerrë në shitje IPKO-n në korrik të vitit të kaluar. Telekom i Serbisë, që është 58 për qind në pronësi të shtetit serb, kishte bërë ofertën për blerjen e operatorit të telefonisë mobile IPKO.



# Ministrja Bajrami paraqet arsyet e shkarkimit të Ilir Murtezajt

**EPOKA  
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Ministrja e Financave dhe Transfereve, Hykmete Bajrami, ka raportuar të mërkurën në Komisionin për Buxhet dhe Transfere lidhur me shkarkimin e Ilir Murtezajt nga posti i drejtorit të ATK-së. Ajo ka thënë se drejtori i shkarkuar i ATK-së, Ilir Murtezaj, ka bërë shumë shkelje. "Drejtori ka hartuar dhe nënshkruar në kundërshtim me ligjin që është në hartim me rregulloren e punës së ATK-së. Kjo shkelje është aprovuar edhe nga Ministria e Administratës Publike, ku thuhet se nuk u është nënshtruar procedurave. Unë kam biseduar me ish-drejtorin dhe më është përgjigjur që ka vepruar në përputhje me ligjin. Nuk qëndron ajo se ai ka vepruar në harmoni me FMN-në. Në një e-mail, ndër të tjera, thuhet se: 'Implementimi i strukturave në ATK ka qenë rekomandimi ynë dhe FMN-së', dhe thotë se nuk e ka marrë për bazë hartimin e

atij ligji.

Ministrja Bajrami ka thënë se shkelja e dytë që ka bërë Murtezaj ka shpallur konkurs për tri pozita të kundërligjshme. "Shkelja është evidentuar edhe nga Ministria e Administratës Publike", ka pohuar Bajrami.

Deputeti i PDK-së, Kujtim Gashi, ka pyetur ministren Bajrami se për çfarë arsye është shkarkuar Murtezaj pasi, sipas tij, raporti i FMN-së dhe raporti i progresit e paraqesin me performancë të mirë ATK-në. "Si mund të shkarkohet një drejtor kur raporti i FMN-së thotë se ka pasur një progres të mirë të zbatimit të planit të ATK-së. Në këto raporte thuhet se janë shtuar mbledhjet e borxheve. Edhe raporti i progresit flet mirë për ATK-në, ku të hyrat thuhet se janë rritur me 4 për qind. Të njëjta i ka paraqitur edhe Banka Botërore. Për të gjitha këto të arritura, a keni menduar se një meritë të vogël mund ta ketë pasur ky drejtor?", ka thënë Gashi.

E ministrja Bajrami i është



përgjigjur pyetjes së deputetit të PDK-së. "Asnjëherë nuk i kam kontestuar raportet botërore. Ka qenë e vështirë të punohet me qindra e-mail që janë marrë duke u ankuar në të dhe nuk mund t'i mbyllesh sytë kur një asistente administrative ngrihet në pozitë tek inspektorët", ka thënë Bajrami. Deputetja Mimoza Kusari-Lila

ka përmendur deklaratat e ish-drejtorit Murtezaj, ku ky i fundit kishte akuzuar për nepotizëm kryeministrin Avdullah Hoti derisa ishte në krye të Ministrisë së Financave. Ajo ka pyetur ministren Bajrami nëse kanë marrë vërejtje me shkrim për performancë të dobët për ish-drejtorin ATK-së dhe të

Doganës. "Nuk kemi dalë për të bërë spektakël medial. Ato shkeljet që i përmenda janë transparente. Në qeverinë e kaluar kanë ndodhur dhjetëra shkarkime dhe asnjë ministër nuk ka ardhur për të raportuar në komision. Unë kam ardhur për të shpjeguar në hollësi vendimet për shkarkim", ka deklaruar ministrja Bajrami.

# Abrashi nënshkruan memorandum për gjelbërimin e rrugëve të Kosovës



Ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me organizatën joqeveritare "Ta pastrojmë Kosovën". Abrashi ka thënë se ky bashkëpunim ka për qëllim të ndikojë edhe në zvogëlimin e ndotjes, duke gjelbëruar rrugët e Kosovës

**EPOKA  
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me organizatën joqeveritare "Ta pastrojmë Kosovën" dhe Komitetin

Olimpik të Kosovës për mbjelljen e fidanëve nëpër rrugët që janë përgjegjësi e Ministrisë së Infrastrukturës. Ky memorandum ka për qëllim forcimin e bashkëpunimit të mëtutjeshëm dhe koordinimin e aktiviteteve mes të tria institucioneve, me qëllim të

promovimit dhe avancimit për mbrojtjen e mjedisit dhe bashkëpunimit të mëtutjeshëm.

Abrashi ka deklaruar se ky bashkëpunim ka për qëllim të ndikojë edhe në zvogëlimin e ndotjes, duke gjelbëruar rrugët e Kosovës. "Po nisim për herë të parë gjelbërimin e rrugëve të Kosovës. Ky veprim do të ketë ndikim në uljen e ndotjes së ambientit. Gjithsesi që rrugët e Kosovës do të marrin pamje tjetër, duke u zbukuruar, por edhe duke ruajtur ambientin", u shpreh Abrashi.

Mes të tjerash, marrëveshja parasheh organizimin e përbashkët të fushatave vetëdijesuese për mbajtje të mjedisit të pastër, në veçanti brezave rrugore të Republikës së Kosovës dhe aksionit për mbjelljen e drunjve në të gjitha rrugët rajonale dhe magjistrale, pjesë e fushatës kombëtare "T'i japim vendit ngjyra".

Vetëm në fazën e parë parashihet mbjellja e 3 000 drunjve përgjatë autostradës "Ibrahim Rugova". Të tria institucionet do të mbajnë takime të rregullta koordinuese dhe të përbashkëta me institucione dhe organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe donatorë të projekteve mjedisore.

## Shërbimi i radiologjisë në QKMF-në e Malishevës do të punojë dy ditë në javë

MALISHEVË, 4 NËNTOR (ER) - Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Malishevës, përkatësisht drejtori i kësaj drejtorie, Liridon Hoti, ka bërë me dije se shërbimi i radiologjisë në QKMF-në në Malishevë, në tre muajt e

ardhshëm do të jetë në shërbim vetëm të hënën dhe martën. Në këtë kontekst, ai ka thënë se të gjithë ata që kanë nevojë për këtë shërbim mund ta bëjnë vetëm dy ditë në javë. Drejtori Hoti ka njoftuar se për shkak të një trajnimit të detyrueshëm për shërbime të

tjera profesionale në QKMF, punëtorët shëndetësorë janë të detyruar që për tre muajt të punojnë me ditë të reduktuara. Pas tre muajsh shërbimi i radiologjisë, bashkë me shërbime të tjera profesionale, do të jetë me ditë të plota gjatë javës.



## Inaugurohet Qendra me Bazë në Komunitet në Zhegër



GJILAN, 4 NËNTOR (ER) - Është inauguruar Qendra me Bazë në Komunitet për fëmijët e moshës 3-5 vjeç, në shkollën "Agim Ramadani" në Zhegër, në kuadër të Projektit "Përmirësimi i qasjes dhe cilësisë në kujdesin dhe zhvillimin gjatë fëmijërisë së hershme".

Drejtorja e Arsimit në kuadër të bashkëpunimit me organizatën "Save the Children International" përmes këtij projekti mëton të kontribuojë për arritjen e synimit që fëmijët e moshës 3-5 vjeç ta gëzojnë të drejtën e tyre për zhvillimin holistic, duke u mundësuar fëmijëve që të rriten me

potencialin e tyre të plotë. Drejtori i Arsimit, Nazim Gatica, ka uruar fëmijët, stafin dhe komunitetin e fshatit Zhegër për hapjen e kësaj qendre si dhe ka falënderuar "Save The Children" për mbështetjen e vazhdueshme dhënë arsimit në Komunën e Gjilanit.

## Shkollat në Drenas furnizohen me pajisje laboratorike

Drenas, 4 nëntor (ER) - Komuna e Drenasit ka furnizuar shkollat fillore të mesme të ulëta me pajisje laboratorike të shkencave të natyrës në kuadër të projektit "Furnizimi i shkollave me pajisje laboratorike". Këto pajisje laboratorike tashmë janë në funksion dhe përmes tyre nxënësve do t'u mundësohet

pragmatizmi i pjesës teorike në shkencat e natyrës. Ky investim është në vazhdim dhe realizimi i premtimeve të kryetarit Ramiz Lladrovci për furnizimin e shkollave me pajisje laboratorike sepse do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë dhe të ngritjes profesionale në karrierë.



## Bahtiri pranon donacion 10 mijë maska për mbrojtje nga Covidi

MITROVICË, 4 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka pritur në një takim drejtorin gjeneral të kompanisë "QTA", Agron Durmishi, i cili ka shprehur vullnetin t'i dhurojë 10 mijë maska mbrojtëse për këtë komunë. Me këtë rast, kryetari Bahtiri ka falënderuar kompaninë në fjalë për dhurimin e këtij donacioni shumë të nevojshëm në këtë kohë pandemie, duke thënë se këto maska mbrojtëse do të

shërbejnë për nevojat e institucioneve dhe të qytetarëve dhe ndihma të tilla janë të mirëseardhura për t'u mbrojtur nga virusi Covid-19. Ndërsa drejtori gjeneral i kësaj kompanie, Agron Durmishi, ka falënderuar kryetarin Bahtiri për pritjen dhe mbështetjen e dhënë bizneseve në Mitrovicë. Kjo nuk është hera e parë që "QTA" dhuron donacione dhe mbështet familjet me asistencë sociale në Komunën e Mitrovicës.



## Nuk respektoi masat anti-Covid, mbyllet një market në Skenderaj

Skenderaj, 4 nëntor (ER) - Komuna e Skenderajt ka bërë me dije se për shkak të mospërfilljes së masave të

Qeverisë së Kosovës për parandalimin e infeksionit Covid-19 është mbyllur përkohësisht një market nga

inspeksioni komunal. Me këtë rast, kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka thënë se vendimet e qeverisë

duhet të respektohen nga të gjithë dhe kjo do të bëhet për të mirën e qytetarëve të kësaj komune.



# Sulmi i Vjenës dhe nevoja për një qasje serioze në raport me diasporën shqiptare



**Shkruan: Valon MURATI**

1. Sulmet terroriste, duke u thirrur në fenë islame, po tronditin këto ditë pandemie Evropën. Të gjithë po solidarizohemi me Francën dhe Austrinë e me të drejtë po i dënojmë sulmet. Në këtë vorbull sigurisht askush nuk ka pritur që të dëgjohet edhe për emra shqiptarësh ndër sulmuesit. Po dalin emra të tjerë ndër policët heronj që janë shqiptarë e, po ashtu, edhe një ndër viktimat. Ndonëse këto dëshmojnë se shumica e shqiptarëve janë qytetarë shembullorë të Austrisë, këto nuk e zbusin problemin. Sulmi në Vjenë dhe përfshirja e shqiptarëve atje është një alarm për shqiptarët kudo e sidomos për shtetet tona - Kosovën e Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Ky sulm vë në pah edhe një herë raportin që duhet të ndërtojmë me diasporën tonë dhe përgjegjësitë tona si shtete për organizimin sa më të mirë të diasporës shqiptare. Përgjegjësitë e njerëzve domosdo që janë individuale, ashtu si aktet e tyre dhe asnjë popull e fe nuk mund të akuzohet për sulmet e individëve, edhe kur ata janë pjesë e grupeve të organizuara terroriste apo kriminale. Sidoqoftë, jashtë përgjegjësisë individuale duhet një mobilizim i diasporës e, mbi të gjitha, i shteteve tona për një organizim më të mirë të diasporës rreth vlerave kombëtare, qytetare e njerëzore, sepse ka një problem që duhet adresuar. E ai është pikërisht radikalizimi i një pjese të rinisë sonë, sado i vogël në numër.

2. Raporti me diasporën shqiptare duhet të jetë më kompleks dhe më i organizuar. Zakonisht diaspora nga këtu është parë nën prizmin e sukseseve të saj atje, të ndihmave financiare që i dërgon në Kosovë dhe të votave që mund të sjellë për subjekte të caktuara politike. Është e vërtetë që shumica e shqiptarëve që jetojnë në Evropën Perëndimore dhe në vendet e tjera janë të integruar

mirë dhe janë qytetarë model të vendeve ku jetojnë. Për më tepër gjeneratat e reja çdoherë e më shumë po bëhen pjesë e shoqërive ku jetojnë duke u ngjitur majave të suksesit në shumë lëmenj të ndryshëm. Sidoqoftë, është një pjesë e vogël që mbetet e marginalizuar dhe potencialisht e brishtë e me mundësi radikalizimi fetar. Është kjo pjesë e paintegruar mirë në vendet ku jeton, ose me probleme identitare, e cila rekrutohet më së lehti nga elementet ekstremiste të islamit politik. Sigurisht se luajnë rol edhe proceset dinamike të globalizimit, hyrja e teknologjisë informative në jetën tonë individuale, sociale e familjare, mbyllja në vetvete dhe probleme të tjera sociale tipike për moshën e adoleshencës, atomizimi dhe ndarjet e familjeve të mëdha partriarkale, dëshpërimet me situatën politike në atdhe etj. Të gjitha këto nën ndikimin kryesisht të imamëve që nuk janë shqiptarë, ose janë shqiptarë të radikalizuar që në mënyrën e vet kanë bërë që rruga e radikalizimit të duket një rrugë e shpëtimit nga ferri dhe rrugë drejt parajsës së premtuar.

3. Në këtë drejtim Shqipëria, Kosova, besa edhe Maqedonia e Veriut nuk i kanë bërë hapat e duhur. Diaspora jonë nuk duhet të lihet e vetmuar dhe pa dorën e shteteve tona. Organizimi i mësimi të gjuhës shqipe, i aktiviteteve kulturore dhe fuqizimi apo krijimi i mekanizmave që merren vetëm me diasporën (qendrat kulturore, shtëpitë e kulturës etj.) janë një ndër rrugët e duhura. Organizimi i mësimi të gjuhës shqipe, ndonëse ndihmohet nga Kosova e Shqipëria, ende nuk është në nivelin e duhur. Qendrat kulturore që patën filluar të hapen jo vetëm që nuk përkrahen në mënyrën e duhur, por nuk është vazhduar me hapjen e qendrave të tjera. Në cilësinë e ish-ministrit të Diasporës kam bërë përpjekje që të forcohet çështja e mësimi të shqipes në diasporë dhe hapja e qendrave kulturore. Për këtë punë janë realizuar edhe një sërë marrëveshesh me Shqipërinë. Për realizimin e tyre ka pasur barriera financiare dhe ngurtësi nga nivelet e tjera qeveritare që të vazhdohet me dinamikë të shtuar. Për ta realizuar një plan

të gjerë të organizimit të mësimi të shqipes ka qenë e planifikuar që Kosova dhe Shqipëria duhet të shpenzojnë bashkërisht diku 1.5 milion euro në vit. Kjo shifër, krahasuar me miliardat që sjell diaspora në Kosovë, Shqipëri dhe në Maqedoninë e Veriut, është një shifër shpërfillëse. Por ka qenë dhe gjithnjë është vështirë që qeveritarët e ndikuar nga politika ditore të mendojnë pak më strategjikisht.

Ndonëse Shqipëria kohët e fundit me krijimin e resorit të diasporës brenda qeverisë ka bërë hapa tutje, Kosova e cila ka qenë më përpara ka bërë hapa prapa jo vetëm për shkak se e ka mbyllur ministrinë e diasporës, por edhe për shkak se nuk e ka ndjekur Shqipërinë për krijimin e mekanizmave të përbashkët si Këshilli Koordinues i Diasporës Shqiptare. Nuk ka sukses në bashkëpunimin me diasporën pa koordinimin në mes të Prishtinës dhe Tiranës.

4. Kam hasur në raste të xhamive nëpër vendbanimet e vogla të Zvicrës ku imamët e tyre u kanë thënë shqiptarëve se ata nuk duhet të mësojnë shqip, por vetëm arabisht e gjermanisht dhe se madje ata as nuk duhet ta trajtojnë veten si shqiptarë, por vetëm si arabë e myslimanë. Duke parë radikalizimin e një pjese të vogël të shqiptarëve në Evropën Perëndimore, duke e parë brengën e shqiptarëve atje se një pjesë e të rinjve po radikalizohen, kam pas filluar të bashkëpunoj edhe me Bashkësinë Islame të Kosovës. BIK-u e di mirë situatën atje, por edhe ky mekanizëm e ka të pamundur që vetë pa ndihmën e shtetit të operojë në ambiente të tilla. I shqetësuar nga këto dukuri, çështjen e radikalizimit fetar si brengë ua kam shprehur edhe niveleve më të larta qeveritare në Kosovë dhe

Shqipëri, duke ua bërë të qartë se investimet që duhet të bëjmë në diasporë janë të papërfillshme në raport me përfitimet që kemi dhe që do të kishim e në anën tjetër dëmet nga shpërfillja e kësaj problematike do të jenë shumë të mëdha. Ua kam thënë se elementet radikale të diasporës, edhe për shkak të ndikimeve familjare e financiare, shumë lehtë mund të fillojnë të bashkëpunojnë me elementet radikale këtu dhe problemet të cilat nuk i kemi të vogla në këtë drejtim të na rriten dhe të bëhen të pamëshueshme. U kam kërkuar strategji për këtë çështje dhe ndërhyrje urgjente të shteteve tona. Në këtë strategji, përveç ndërhyrjes në fuqizimin e organizimit të mësimi të shqipes, organizimin e qendrave kulturore, vazhdimin dhe fuqizimin e organizimit të rrjeteve të të rinjve, profesionistëve, e bizneseve, duhet të përpunohet edhe një plan veprimi i përbashkët shtetëror i Kosovës, Shqipërisë, por edhe Maqedonisë së Veriut me BIK-un, Komunitetin Mysliman në Shqipëri si dhe Bashkësinë Islame të Maqedonisë së Veriut që të punohet me këto komunitete ku kanë depërtuar organizime fetare radikale. Gjithashtu, duhet të punohet me shtetet pritëse që organizimi fetar i diasporës sonë të jetë i drejtuar kah mekanizmat legalë fetarë që operojnë në atdhe dhe të mbyllin xhamitë me orientime radikale e pa lidhje me këta mekanizma. Gjithashtu, të kërkohet bashkëpunim më i ngushtë me këto shtete për organizimin e mësimi shqip si një element i rëndësishëm i dekontaminimit të radikalizimit fetar. Vështirë është që me përpjekje të ndara të ndërhyhet në këtë komunitet marginal, por mjaftueshëm i dëmshëm

për veten, për shqiptarët dhe për vendet mike ku ata jetojnë.

5. Në këtë përpjekje mund të garantoj sot që shtetet tona e kanë dorën e zgjatur të qindra mijëra djemve dhe vajzave të mrekullueshme në diasporë dhe të qindra e mijëra intelektualëve, biznesmenëve, politikanëve, sportistëve e aktivistëve të vjetër e të rinj që çdo ditë punojnë me komunitetin shqiptar. Ajo që duhet sot është një përfshirje e jona më serioze institucionale në organizimin e diasporës. Pra përfshirje e shteteve tona, jo e politikës së partive politike sepse vazhdoj të kam bindjen e plotë se po e dëmtojnë rëndë organizimin dhe unitetin e diasporës sonë. Kam qenë kundër organizimit partiak si një mekanizëm që vetëm copëton diasporën, fut energji negative në mesin e njerëzve dhe shpërndan forcat tona atje. Po angazhimin politik në partitë politike të vendeve ku jetojnë dhe përfshirje në jetën institucionale të atyre vendeve. Kjo është rruga e duhur për fuqizimin e diasporës dhe faktorit shqiptar në Ballkan.

6. Në anën tjetër duhet theksuar se vetëm me fuqizimin e identitetit shqiptar të diasporës sonë ajo mbetet evropiane. Vetëm me këtë karakter identitar ajo edhe më lehtë integrohet në shoqëritë ku jeton sot. Goditja e këtij identiteti vitet e fundit është duke e bërë punën e tij djallëzore. Në Kosovë përpjekjet kosovacentriste për 'kombin' e ri kosovar dhe relativizimi i të gjitha vlerave kombëtare në Shqipëri, Kosovë e në Maqedoninë e Veriut (si, p. sh., e figura e Skënderbeut, Rilindja Kombëtare, Lufta për Pavarësi etj.), e hapin kutinë e Pandorës e cila i lë shqiptarët pa identitet të qëndrueshëm dhe mundëson depërtimin e identiteteve të tjera, e sidomos në këto kohët e fundit identitetet ekstremiste të islamit politik. Kombi shqiptar i ndërtaur, duke i shkrirë fetë brenda vetes, por jo i ndërtaur mbi një fe, është një komb sekular i cili toleron fetarët dhe jo fetarët, por nuk toleron dominimin e njëres palë mbi tjetrën dhe është barriera më e madhe ndaj çdo ekstremizmi fetar apo edhe ekstremizmi tjetër politik. Përndryshe duke minuar kombin shqiptar dhe shtyllat mbi të cilat ndërtaur ai, vetëdijshëm e pavetëdijshëm po e minojmë shoqërinë tonë sekulare, multikulturore, multifetare si dhe demokracinë tonë evropiane.





Izet Sarajliqi (1930-2002) është një ndër poetët boshnjak më të njohur. Sarajliqi është konsideruar një prej autorëve kryesorë të Evropës Lindore dhe është kandiduar për çmimin Nobel për letërsi. Sarajliqi ka qenë anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Bosnje dhe Hercegovinës. Është vlerësuar me shumë çmime, edhe me çmimin prestigjioz "Alberto Moravia" (2001). Gjatë luftës (1992-1995) refuzoi të largohej nga Bosnja. Në këtë luftë, në të cilën u plagos, humbi dy motrat, Ninën dhe Razën, të cilat përmendën në këtë libër. Poezitë e Sarajliqit janë përkthyer dhe botuar në: italisht, frëngjisht, holandisht, gjermanisht, slovenisht, rusisht, lituanisht, anglisht, turqisht, maqedonisht, spanjisht, në gjuhën polake e në disa gjuhë të tjera të botës, edhe në shqip.



Në parathënien e këtij libri është ky paragraf: *Në Sarajevë, të cilën e deshi shumë dhe me poezi shkruar për të e bëri të njohur në mbarë botën, pothuajse askush nuk e kujton më. Madje asnjë rrugë të këtij qyteti nuk ia dhanë emrin e tij.* Kështu shkruan dhe shpreh shqetësim e bija e poetit, Tamara Sarajliq Slavniq, e cila, në korrespondencat me postë elektronike, na njofton se babai i saj, Izeti, sa ishte gjallë kishte qenë disa herë në Prishtinë, se i donte shumë shqiptarët, se u fliste fëmijëve të vet shumë për qytetet e Kosovës, për takimet që kishte pasur disa herë me poetë shqiptarë në mbremjet poetike që atëkohë organizoheshin në Kosovë dhe në Maqedoni. Po ashtu, shpreh kënaqësi që, pas librit të parë, *Kërkoj rrugë për emrin tim*, përkthyer në gjuhën shqipe, në fund të viteve '70, nga Azem Shkreli, Enver Gjergjeku, Qerim Ujkanë, Ali Podrimja dhe botuar nga *Rilindja* më 1978, po në shqipe po i përkthehet dhe botohet libri i dytë, *Përmbledhja sarajevase e luftës*. Falënderimet e saj, për shtëpinë tonë botuese dhe për ata shqiptarë që kujdesen për vlera letrare dhe njerëzore, për ata shkrimtarë që i do dhe i kërkon bota, që janë institucione të kujtesës kombëtare, që ua kujtojnë gabimet shteteve dhe udhëheqësve të tyre, janë shumë të njerëzishme dhe janë shumë miqësore. Pas shumë fjalëve të saj për punën tonë, i kemi dërguar në fund këtë fjali: *Boshnjakët edhe mund ta barrojnë luftën, edhe ta barrojnë Sarajliqin, por ne s'do ta barrojmë kurrë luftën e Bosnjës në vargjet e Izetit; s'do ta barrojmë kurrë masakrën që i është bërë popullit të tij; s'do ta barrojmë kurrë fatin e përbashkët që kishim: ju vetëm atje, ne shqiptarët këndo.*

N. Sh. Armagedoni

4.99 €



## PËRMBLEDHJA SARAJEVASE E LUFTËS



**IZET SARAJLIQ**

Përktheu: Salajdin Salihu  
Shkroi parathënien: Tamara Sarajliq Slavniq



INTERVISTË ME SHKRIMTARIN ADIL OLLURI

# Me letërsi nuk mbijetohet, me letërsi jetohet

Intervistën e realizoi  
Xhemazije RIZVANI

## Ç'do të thotë të jesh shkrimtar në Prishtinë?

E dashur Xhemazije, nëse dëshiron të të gënjej, mund të të them se në Prishtinë është shumë bukur të jesh shkrimtar, sepse ngado që të shkosh njerëzit të njohin e të çmojnë; në secilën lagje të saj mund të takosh lexues të panjohur të veprës sate, që të ndalin dhe të përshëndesin; në shumë kafene të saj mund të hasësh njerëz që janë duke biseduar rreth ngjarjeve që i ke krijuar dhe të bëmave të personazheve të prozës sate. Kjo është një gënjeshtëri e bukur të cilën nuk bën ta themi as kur jemi të dehur, sepse do të na merrnin për të shkalluar.

## Cilët janë lexuesit idealë të krijimtarisë sate?

Lexues idealë të prozës sime artistike i mendoj ata që bashkëndiejnë me të ndodhurat në rrëfimet që i krijoj, që bashkëndiejnë me fatet e personazheve të prozës sime. Jo çdoherë i pëlqej lexuesit me përgatitje të lartë akademike, sepse ata jo rrallë dinë të bëjnë hile dhe të mos e thonë atë që e ndiejnë dhe atë që e mendojnë. Një lexues që pyet, që mendon, që reflekton pas leximit, është lexuesi im më ideal, pa marrë parasysh nivelin akademik të reflektimit të tij. Thjesht, do ta dëshiroja lexuesin që pyet, lexuesin kureshtar e të pasherr.

## Për çfarë ndieni keqardhje më shpesh?

Kur nuk mund t'i ndihmoj njerëzit kur kanë nevojë më së shumti.

## Çfarë ju fyen më së shpeshti?

Fyhem nga shumë gjëra. Po t'ju tregoja këtu për të gjitha, do të na shkonte gjysma e kësaj bisede. Megjithatë, në javët e fundit kam filluar të ofendohem nga studiuesit mediokër në Prishtinë, të cilët, pa fije turpi më thonë troç, "se ende nuk t'i kemi lexuar regjimet dhe romanin tënd, por na pëlqen të rrimë e të llafosemi me ty, sepse je burrë i mbarë". Kjo është një nga fyerjet më të rënda që mund t'i bëhet një krijuesi. Përmes kësaj interviste u bëj thirrje të gjithë mediokërve, që të gjejnë ndonjë metodë tjetër për të qenë afër meje.

## Kush janë shpirtrat e përzënë?

"Shpirtrat e përzënë" janë personazhet e romanit tim "Bartësi i shpirtave të përzënë", i ribotuar tash së voni nga shtëpia e mirënjohur botuese "Onufri", e cila është një markë tejet e vlerëshme e botimit të librit letrar. Një brend i editorësisë shqipe, që



më ka nderuar mua dhe krijimtarinë time letrare. "Shpirtrat e përzënë" janë të frikësuarit, të shpërngulurit, të zakonshmit shqiptarë të Kosovës, që i përjetuan tmerret e eksodit gjatë luftës së fundit në vendin tonë.

## Cilët libra i ke të shenjtë?

Unë lexoj dhe vlerësoj shumë vepra, por nuk e kam guximin ta cilësoj të shenjtë ndonjërin apo disa prej tyre. Cilësori "libër i shenjtë" vetëm dëme i ka bërë njerëzimit.

## Në çfarë shpresoni?

Shumë pak shpresoj, shumë pak. Më shumë planifikoj. Jo rrallëherë më dështojnë planet. Tash për tash, të vetmen shpresë e kam se, ndoshta, ndonjë ditë lexuesi shqiptar do t'i kthehet letërsisë shqipe.

## A mendoni se jeni i ndryshëm nga shkrimtarët e tjerë shqiptarë?

Këtë gjë nuk mund ta them dhe nuk mund ta vlerësoj unë. Pres të ma thoni ju.

## Ç'do të thoshin fëmijët tuaj për ju, për babanë?

Ende janë të vegjël dhe ende nuk mund ta marr me mend se ç'do të mund të thonë pas disa vitesh për mua. Ndoshta edhe do të krenohen për mua, ku i dihet! Ndoshta edhe do të më thonë "bab', ç'tu desh të merresh me një punë kaq të pabereqetshme me të cilën nuk mund të na blesh celularin e modelit më të ri, ku i dihet! Ndoshta edhe mund të më thonë: "Bab', pse t'u desh të merresh me një punë që të tensiononte kaq shumë, me të cilën ke bërë më shumë urrejtës sesa dashamirë e miq?! Ku i dihet!

## Nga çfarë ka frikë Adil Olluri?

Kam frikë se në të ardhmen fëmijët do të më thonë: "Bab', a ke ndonjë mik në qeveri se nuk po mund të gjejmë punë askund". Ose: "Bab', a ke ndonjë mik në filan ambasadë që të na mundësojë ta marrim vizën më lehtë e më shpejt". Mund të ndodhë dhe më e keqja: "Bab', unë po largohem nga ky vend që ti dhe miqtë e tu nuk e ndërtuat dot".

## Ç'do të thotë të jesh krijues i sotëm?

Në një shoqëri që i respekton shkrimtarët vetëm kur të vdesin, më së vështiri është të jesh krijues i sotëm. Është vështirë, sepse ti je ende gjallë. Shqiptarët, me përjashtime të vogla, nuk e duan shkrimtarin. Më shumë iu pëlqen ta përkujtojnë në përvjetorët e tij jubilarë.

## Ç'është për ju liria?

Liria për mua dhe për të gjithë shqiptarët e Kosovës është më shumë se një ndjesi. Liria për ne është identiteti.

## Si mund të shpëtojmë bashkërisht?

Ballkani në përgjithësi mund të shpëtojë bashkërisht vetëm nëse nuk i bën gabimet e së kaluarës. Shqiptarët duhet ta shohin veten si pjesë e bashkëveprimeve dhe paqes së përhershme në Ballkan. Ne këtu jetojmë, këta fqinjë kemi, nuk mund ta ndryshojmë gjeografinë. Nuk mund ta vendosim as Kosovën e as Maqedoninë e Veriut diku pranë Danimarkës apo Kanadasë. Duhet të jetojmë në paqe të përhershme me serbët, maqedonasit, grekët, bullgarët, malazezët e të tjerët.

## Çfarë ka të vdekur brenda nesh?

Nuk më kujtohet nëse ka qenë ndonjëherë e gjallë, sepse nuk jam edhe aq shumë i moshuar për të folur për të kaluarën, por ajo që mendoj se ka vdekur te njeriu i sotëm është empatia, kuptimi i nevojave dhe qëllimeve të tjetrit, ndjesia për tjetrin. Ka humbur ndjesia për të menduar për tjetrin si për veten. Kjo është e dhimbshme.

## A mbijetohet me letërsi?

Me letërsi nuk mbijetohet. Me letërsi jetohet. Ata që kanë qëllim parësor mbijetesën materiale e ekonomike përmes letërsisë, më mirë le t'u ngasin veturave të tyre në rrugë të tjera. Është një gjë e pamundshme edhe për vende më të mëdha e më të zhvilluara, lëre më për vende të vogla si Kosova, Shqipëria e Maqedonia e Veriut. Në vende si tonat, një krijues mund t'i vjelë frytet materiale dhe ekonomike vetëm nëse arrin ndonjë sukses të madh ndërkombëtar ose kur të jetë në një moshë të shtyrë, kur paratë nuk i duhen edhe aq shumë, meqë atëherë më shumë i duhet shëndeti i plotë sesa kuleta e mbushur plot.

## Për çfarë je pënduar në jetë?

Javët e fundit jam ndier i pënduar që nuk jam bërë pjesë e kauzave për t'i bindur të rinjtë kosovarë që të mos shkojnë në luftëra të huaja, në Siri e gjetiu në Lindjen e Mesme. Shumë të rinj shqiptarë të Kosovës janë vrarë në ato lufta dhe ne nuk kemi arritur t'i bindim që të mos mashtrohen nga klerikë të rrymave ekstremiste religjioze. Shkrimtarit nuk i falet heshtja përballë vdekjeve të të rinjve, që do të mund të ishin profesionistë

e punëtorë të zotë në Kosovë.

## Po të takoheshit me veten sy me sy, ç'do t'i thoshit?

Po ta takoja veten time sy më sy do t'ia jepja dy porosi. Së pari, mos u bëj shumë i mirësjellshëm, sepse shqiptarët mirësjelljen e marrin për qyqarllëk. Së dyti, mos rri në një tavolinë me ata që nuk të respektojnë, madje as për kurtuazi. Nuk ia vlen. Jeta është e shkurtër për t'i duruar nebulozat dhe arrogancën e pabazë që prodhon mendësia provinciale.

## Politika dhe ju?

Më pëlqen të qenit apolitik, por jo apolitik. Më shqetësojnë ndodhitë dhe problemet politike në Kosovë. Për të mos e zgatur më shumë, e sotmja politike e vendit tim nuk të lë të jesh aq fodull dhe të thuash që mua nuk më intereson asgjë.

## Në shtetin tënd ideal, si do të trajtohej një shkrimtar?

Në shtetin ideal shkrimtari respektohet, nuk trajtohet. Në një shtet ideal shkrimtari do të duhej të respektohej si zë i fuqishëm intelektual, si një këshilltar moral i një shoqërie.

## Kush është Adil Olluri?

Adil Olluri është shkrimtar. Është duke e shkruar një roman të ri. Është një prozator që ka qëllim ideal takimin me lexuesin vetëm përmes veprës, artit të shkrimit. Por, ajo që më së shumti e vlerësoj te vetja është fakti se për asnjë çast nuk më venitet pasioni për ta lexuar letërsinë artistike. Është një vrull që nganjëherë më bën të lexoj, përpos veprave të arrira letrare, edhe ato vepra që nuk do t'ia propozoja askujt./Telegrafi



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT  
SEKRETARIA / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121; në mbështetje të rregullit 19 dhe 20 të Rregullores së punës Nr. 01/2018 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës; si dhe në mbështetje të Rregullores Nr. 04/2015, për Procedurat e rekrutimit, të emërimit dhe të punës provuese të stafit të Gjykatës Kushtetuese, Sekretariati shpall:

### KONKURS Për plotësimin e vendit të punës

**Pozita:** Përkthyes nga shqipja në anglisht e serbisht dhe anasjelltas  
**Kodi:** SP-DPP-04-06  
**Numri i pozitave:** 1 (një)  
**Kohëzgjatja e emërimit:** I karrierës (pa afat)  
**Puna provuese:** 1 (një) vit

#### Përshkrimi i përgjithshëm i pozitës:

Përkthimi me shkrim dhe i atypëratyshëm i teksteve, i materialeve, i shkresave, i dokumenteve dhe i ligjeve nga shqipja, anglishtja e serbishtja dhe anasjelltas, si dhe ofrimi i përkrahjes cilësore për përkthimin, duke u përkujdesur për dukjen e dokumentit të përkthyer në përputhshmëri me dokumentin origjinal, nën mbikëqyrjen e drejtorit të Departamentit të Përkrahjes Profesionale. Përkthimi i atypëratyshëm nga shqipja, anglishtja e serbishtja dhe anasjelltas gjatë takimeve dhe seancave të punës në Gjykatën Kushtetuese.

#### Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Përkthen me shkrim materiale dhe dokumente të Gjykatës Kushtetuese nga gjuha shqipe në atë angleze e serbe dhe anasjelltas;
- Përkthim i atypëratyshëm gjatë takimeve dhe gjatë seancave të Gjykatës nga gjuha shqipe në atë angleze e serbe dhe anasjelltas;
- Përkujdeset për strukturën e fjalëve dhe të fjalive në dokumentet e përkthyer;
- Ndihmon dhe bashkëpunon me redaktorët/lektorët e Gjykatës në përcaktimin dhe në harmonizimin e terminologjisë së teksteve të përkthyer;
- Ndihmon dhe shoqëron gjyqtarët në takime pune dhe vepron si përkthyes/shpjegues; dhe
- Kryen edhe punë të tjera, sipas kërkesës së drejtorit të Departamentit të Përkrahjes Profesionale.

#### Kualifikimet minimale dhe përvoja e përgjithshme:

- Përgatitje universitare, preferohet në fushën Filologjike dhe Juridike;
- Së paku 2 (dy) vjet përvojë përkatëse profesionale në përkthime.

Përkthyesi duhet të jetë energjik, të ketë shkathtësi të mira ndërnjerëzore dhe të jetë i gatshëm të punojë me orar fleksibil të punës. Shkathtësia dhe aftësia në përdorimin e kompjuterit dhe të softuerëve aplikativë, si: MS Word, duke përfshirë përpunimin e avancuar të tekstit, MS Excel dhe MS Outlook, është e domosdoshme.

#### Informata të përgjithshme për kandidatë

Përcaktimi i pagës, për pozitën e shpallur, bëhet në përputhje me Rregulloren e punës dhe me vendim të Gjykatës Kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese ofron mundësi të barabarta punësimi dhe mirëpret aplikacionet nga pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë dhe nga kandidatët femra. Politika e përfaqësimit gjinor dhe e të gjitha komuniteteve të Kosovës do të zbatohet gjatë procedurës së rekrutimit në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

#### Procedura e konkurrimit

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin aplikacionin përkatës, të shoqëruar nga një biografi profesionale, një letër motivuese dhe dokumentacionin përkatës për përgatitjen shkollore dhe për përvojën e kërkuar të punës.

Forma e aplikacionit mund të merret në kopje fizike në recepcionin e Gjykatës Kushtetuese dhe mund të shkarkohet nga ueb-faqja e Gjykatës Kushtetuese: [www.gjk-ks.org](http://www.gjk-ks.org).

Aplikacioni, me të gjitha dokumentet, mund të dërgohet nëpërmjet emailit në adresën: [gjk.burimetnjerezore@gjk-ks.org](mailto:gjk.burimetnjerezore@gjk-ks.org), nëpërmjet shërbimit postar, apo të dorëzohet në Departamentin e Administratës dhe Burimeve Njerëzore të Gjykatës Kushtetuese (DABNJ) në kopje fizike.

Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në ueb-faqen e Gjykatës si dhe shpalljes publike duke filluar nga data 5.11.2020 deri më datën 25.11.2020, që konsiderohet ditë e fundit e mbylljes së konkursit.

**Data e fundit për pranimin e aplikacioneve është 25/11/2020, deri në ora 16.00.**

#### Shënim:

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT  
SEKRETARIA / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT

Shodno çlanu 12. Zakona o Ustavnom sudu Republike Kosovo, br. 03/L-121, pravilu 19. i 20. Poslovnika o radu Ustavnog suda Republike Kosovo, br. 01/2018, kao i u saglasnosti sa Uredbom br. 04/2015 o postupcima zapošljavanja, imenovanja i probnog rada za osoblje Ustavnog suda, Sekretarijat raspiše:

### KONKURS za popunu radnog mesta

**Pozicija:** Prevodilac sa albanskog na engleski i srpski i obrnuto  
**Kod:** SP-DPP -04-06  
**Broj pozicija:** 1 (jedan)  
**Trajanje imenovanja:** Karijerno (neodređeno)  
**Probni rad:** 1 (jedna) godina

#### Opšti opis pozicije:

Pismeno i simultano prevođenje tekstova, materijala, dopisa, dokumenata i zakona sa albanskog, engleskog i srpskog i obratno, kao i pružanje kvalitetne podrške prevoda, obezbeđujući da je izgled prevedenog dokumenta u potpunom skladu sa originalnim dokumentom, pod nadzorom direktora Departmana za profesionalnu podršku. Simultani prevod sa albanskog, engleskog i srpskog jezika i obrnuto tokom sastanaka i radnih sednica Ustavnog suda.

#### Glavne dužnosti i odgovornosti:

- Pismeno prevodi materijale i dokumenta Ustavnog suda sa albanskog na engleski i srpski jezik i obrnuto;
- Simultan prevod tokom sastanaka i sednica Suda sa albanskog na engleski i srpski jezik i obrnuto;
- Stara se o strukturi reči i rečenica u prevedenim dokumentima;
- Pomaže i saraduje sa urednicima/lektorima Suda u određivanju i usklađivanju terminologije prevedenih testova;
- Pomaže i prati sudije na radnim sastancima i deluje kao prevodilac/tumač; i
- Obavlja i druge poslove na zahtev direktora Departmana za profesionalnu podršku.

#### Minimalne kvalifikacije, radno iskustvo i sposobnosti:

- Viša stručna sprema, poželjno iz filološke i pravne oblasti;
- Najmanje 2 (dve) godine relevantnog stručnog iskustva u prevođenju.

Prevodilac treba da bude energičan, da poseduje dobre međuljudske osobine i da je spreman da radi sa fleksibilnim radnim vremenom. Poznavanje rada na računaru i softverskim aplikacijama, kao što je: MS Word, uključujući naprednu obradu teksta, MS Excel i MS Outlook je obavezna.

#### Opšte informacije za kandidate

Određivanje plate za objavljeno radno mesto se vrši u skladu sa Poslovníkom o radu i odlukom Ustavnog suda.

Ustavni sud pruža jednake mogućnosti zapošljavanja i očekuje zahteve od pripadnika nevećinskih zajednica i ženskih kandidata. Politika rodne zastupljenosti i svih zajednica na Kosovu će biti sprovedena tokom procedure prijema u Ustavnom sudu Republike Kosovo.

#### Procedura konkurisanja

Zainteresovani kandidati treba da podnesu odgovarajući zahtev, kome prilažu profesionalnu biografiju, motivaciono pismo, kao i odgovarajuću dokumentaciju o školskoj spremi i potrebnom radnom iskustvu.

Zahtev se može dobiti u štampanoj formi na prijavnici Ustavnog suda i može se preuzeti sa internet stranice Ustavnog suda [www.gjk-ks.org](http://www.gjk-ks.org).


Zahtev i sva ostala dokumenta mogu se podneti putem elektronske pošte, na sledeću imejl adresu: [gjk.burimetnjerezore@gjk-ks.org](mailto:gjk.burimetnjerezore@gjk-ks.org), putem poštanske službe ili u štampanoj formi u kancelariji Odeljenja za administraciju i ljudskih resursa (OALJR) Ustavnog suda.

Unutrašnja konkurencija ostaje otvorena 15 (petnaest) dana od dana objavljivanja na internet stranici Suda i javnog oglasa, počevši od datuma 05/11/2020 do datuma 25/11/2020. koji se smatra poslednji dan zatvaranja konkurisanja.

**Poslednji datum za prijem zahteva je 25/11/2020, do 16.00 časova.**


#### Napomena:

Zahtevi podneti nakon poslednjeg datuma neće biti primljeni. Nekompletni zahtevi mogu biti odbijeni.



**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898  
Sallon Depilimi Lume's Details  
lumesdetails  
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



**Gjeje PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook [www.facebook.com/gjejepuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejepuneshpejte)

**RESTAURANT**

**SWISS**

**TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553  
PRISHTINË

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

"Lemon Tree Italia" Sh.p.k, me numër UNIK Identifikues: 810711011 dhe me numër fiskal: 600779998 si dhe me numër të Biznesit: 70829428 me seli në Suhodoll, magjistratja Prishtinë – Lipjan, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit dhe numrin fiskal.

► Shefki Shala shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I.I.II,IV dhe diplomën e Sh.M.T. "Nexhmedin Nixha" – Elektroinstalues, Gjakovë.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

